



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIK OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

KONTRATA

E përpiluar me datën 20.11.2024 në Lipjan ndërmjet

Komunës së Lipjanit të cilën e përfaqëson drejtori i prokurimit në Lipjan z. Bekim Shabani në njërën anë (në tekstin e mëtejshëm) Autoriteti Kontraktues, dhe

Emri i Kontraktuesit MODELI INVEST GROUP SH.P.K., Lipjan, 14000, Lipjan, Kosovë, i përfaqësuar nga Pajtim Lubovci (në anën tjetër) në tekstin e mëtejshëm kontraktuesi.

Titullin e kontratës: “Rehabilitimi i trotuarit në ZE- Qylagë”

me numër identifikues 613-24-12085-5-4-7

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është përformimi i punëve në vijim nga ana e ofruesit të punimeve: Pastrimi i gropës në trotuar, Furnizimi dhe shtrirja dhe ngjeshja me material 0.150 mm, Furnizimi transporti dhe montimi i tubit (për puseta) prej betonit të armuar Ø1000/1000mm në cmim të parashihet dhe konusi dhe kapaku, Furnizimi, transporti dhe shtrirja shtresës komunikuese në trotuare nga kubzat e betonit me trashësi prej 8 cm MB40, ngjeshja e tyre dhe punimi i fugave. Forma 20x20, Vendosja e skajorëve 10/20 MB40 M100 anash trouareve të ngritur në shtresë betoni, Zhvendosja e kopormanit, dhe lidhja me rretin egzistues të zonës ekonomike, në cmim të parashihet dhe punimi i bazës prej betoni, dhe kabllo 5 m' (me zhvendosje nenkuptojmë gjitha elementet deri në funksionalizim), Montimi i shtyllës egzistuese me mbjellje, në cmim të parashihet gjitha elementet deri në funksionalizim të saj lidhja me kabllo furnizuese, shiriti tokzimit, siguresat etj. Furnizimi dhe montimi i dritës me fuqi LED me fuqi 90W.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrim të kontratës. Periudha e ekzekutimit të punimeve është nga nënshkrimi i kontratës, përfundimi 20 ditë kalendarike.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë zona ekonomike Qylage.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi i përgjithshëm për kryerjen e punimeve shprehur në shifra është 945.00 € shprehur me shkrim nentëqind e katerdhjetë e pese /Euro/ e zero /cent/.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro. Pagesa do të bëhet pas përfundimit të të gjitha punimeve

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i puneve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Vonesat në ekzekutim

7.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së puneve të dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 8 Inspektimi dhe testimi

8.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë materialet dhe shërbimet e kryera, në mënyrë që të përcaktojë nëse shërbimet janë kryer sipas paramasës në kontratë. Menaxher i kontratës caktohet Armend Aliu, ndërsa mbikëqyrës i kontratës caktohet Sead Aliu.

Neni 9 Nën-kontraktimi

9.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një palë të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

10.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

11.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 18 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 12 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

12.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

12.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në pajtim me ligjin e Kosovës.





Neni 13 Komunikimi

13.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *Shqip* në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Bekim Shabani	Emri:	Pajtim Lubovci
Pozita:	Drejtor i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	20.11.2024	Data:	20.11.2024
Vula:		Vula:	

Rregullimi i trotuarit ne ZE-Qylag

Përshkrimi i punëve

1	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Totali me TVSH (€)
1.1	Pastrimi i gropës ne trotuar, thekja e theut te tepert, ngjeshja e fundit te gropës.	m2	12	10	€ 120.00
1.2	Furnizimi dhe shtrirja dhe ngjeshja me material 0.150 mm	m3	16	10	€ 160.00
1.3	Furnizimi transporti dhe montimi i tabit (për puseta) prej betonit të armuar Ø1000/1000mm ne cmim te parashitet dhe konusi dhe kapaka.	cope	1	100	€ 100.00
1.4	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së fundit të cerex , fraksion 4-8 mm . Në cmim te përshitet edhe planifikimi i shtresës me saktësi ±1 cm	m3	1.5	10	€ 15.00
1.5	Furnizimi, transporti dhe shtrirja shtresës komunikuese ne trotuare nga kubzat e betonit me trashësi prej 8 cm MB40 , ngjeshja e tyre dhe punimi i fugave. Forma 20x20	m2	7	25	€ 175.00
1.6	Vendosja e skajorëve 10/20 MB40 M100 anash trouareve te ngritur ne shtrese betoni	m'	5	20	€ 100.00
1.7	Zhvendosja e kopormanit, dhe lidhja me trefin egzistues te zones ekonomike, ne cmim te parashitet dhe punimi i bazez prej betoni, dhe kablo 5 m'. (me zhvendosje neokuptojm gjitha elementet deri ne funksionalizim)	cope	1	100	€ 100.00
1.8	Montimi i shtyllës egzistuese me mbjellje, ne cmim te parashitet gjitha elementet deri ne funksionalizim te saj lidhja me kablo furnizuese, shiriti izolimi, siguresat etj.	cope	1	100	€ 100.00
1.9	Furnizimi dhe montimi i drites me fuqi LED me fuqi 90W,	cope	1	75	€ 75.00
					€ 945.00
RIKAPITULLIMI PARAMSA DHE PARALLOGARIA					
	Përshkrimi	VLERA ME TVSH			
	TOTALI ME TVSH:	€ 945.00			